



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK
V E N D I M
K.P.P.594/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.08.2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave datë 22.06.2017 mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Saer Medical” sh.p.k në procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozim*” me objekt “Blerje filma skaneri, grafie dhe solucione”, me fond limit 1.000.000 lekë pa tvsh i ndarë në lote:

- Loti 1 “Filma rontgeni dhe solucione”, me Nr.REF-16333-06-05-2017, me vlere 924 402 leke pa tvsh, e zhvilluar në datën 19.06.2017, nga autoriteti kontraktor, Spitali “Ihsan Cabej” Lushnjë.
- Loti 2 “Filma skaneri”, me vlere 75 598 leke pa tvsh, me Nr.REF-16335-06-05-2017,e zhvilluar në datën 19.06.2017, nga autoriteti kontraktor, Spitali “Ihsan Cabej” Lushnjë.

Ankimues:

“Saer Medical” shpk
Rruga “Themistokli Gërmenji”, pallati 11 Shkalla 4, Ap.5 Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria e Spitalit “Ihsan Cabej” Lushnjë
Adresa: Lagja “Xhevdet Nepravishta” Lushnjë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë, 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, pretendimet e tij dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky operator ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

Public Health Sector

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 06.06.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me objekt “Blerje filma skaneri, grafie dhe solucione”, me fond limit 1.000.000 lekë pa tvsh i ndarë në lote:

- Loti 1 “Filma rontgeni dhe solucione”, me Nr.REF-16333-06-05-2017, me vlere 924 402 leke pa tvsh, e zhvilluar në datën 19.06.2017, nga autoriteti kontraktor, Spitali “Ihsan Cabej” Lushnjë.
- Loti 2 “Filma skaneri”, me vlere 75 598 leke pa tvsh, me Nr.REF-16335-06-05-2017, e zhvilluar në datën 19.06.2017, nga autoriteti kontraktor, Spitali “Ihsan Cabej” Lushnjë.

II.2. Në datën 19.06.2017 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Referuar informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë KPP, me shkresën 993/1 prot. datë 02.08.2017 protokolluar me tonën me nr. 1224/3 datë 03.08.2017 me objekt “Dërgim informacioni”, rezulton se në datën 22.06.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

Për lotin I

“Bylis Pharma”	nuk ka ofertë ekonomike
“Saer Medical”	779.850 lekë skualifikuar
“Albaphoto” shpk	870.000 lekë skualifikuar

Për lotin II

“Bylis Pharma”	nuk ka ofertë ekonomike
“Saer Medical”	75.400 lekë skualifikuar

II.4. Në datën 22.06.2017 operatori ekonomik “Saer Medical” shpk, është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

Nuk ka paraqitur Licensë QKL ose QKR për import-eksport tregëti të materialeve për përdorim mjeksor

II.5. Në datën 29.06.2017 operatori ekonomik “Saer Medical” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij me argumentat si më poshtë:

[...]

Si arsye skualifikimi është përdorur fakti që nga ana e shoqërisë tonë nuk është paraqitur Licenca QKL ose QKR për Import-Eksport, tregëti të materialeve për përdorim mjeksor.

Arsyeja e skualifikimit të shoqërisë sonë nga kjo procedurë prokurimi na duket e padrejtë pasi bazuar në VKM-në nr. 538 datë 26.05.2009 për “Licencat lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të Licencimit (QKL)dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”

Aktiviteti: “Import-Eksport tregëti të materialeve me përdorim mjeksor”, nuk është një aktivitet i cili licencohet nga QKL apo Ministria e Shëndetësisë dhe materialet mjekësore mund të tregtohen lirish nga oe i cili operon në këtë fushë apo në fusha të ngjashme. Të vetmet aktivitete të cilat licencohen nga QKL apo Ministria e Shëndetësisë janë:

Kategoria II.6 Shërbime mjekësore parësore, spitalore ose të stamatologjisë.

Kategoria II.7 Prodhimi dhe/ose tregtimi i barnave për njerëz ose kafshë

Kategoria II.8 Shërbime të tjera shëndetësore dhe/ose Higjeno Sanitare. Përsa më sipër kërkojmë ndryshimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e shqërisë tonë nga kjo procedurë prokurimi.

Besojmë se kërkesa jonë është e drejtë, e bazuar në ligj dhe so të merret parasysh.

II.6. Në datën 30.06.2017 nëpërmjet shkresës nr. 862/2prot autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit, duke e refuzuar ankesën me argumentat e mëposhtme:

Autoriteti kontraktor ka sqaruar se:

[...]

Në pikën 2.1 Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë kërkohet: Licencë QKL dhe/ose QKR për import-eksport, tregti të materialeve për përdorim mjekësor.

Komisioni i vlerësimit të ofertave ka qënë i detyruar të zbatoi kriteret e vendosura nga njësia prokuruese në DST dhe për skualifikimin tuaj.

Pra pretendimi juaj qëndron por këtë ankesë duhej ta kishit paraqitur Brenda afatit ligjor, përpara se të hapej vlerësimi i ofertave në mënyrë që të bëhej modifikimi i DST-ve[...]

II.7. Në datën 05.07.2017 ankimesi ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar pretendimet si vijon:

Shoqëria jonë ka qënë pjesmarrëse në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit, por pas vlerësimit të ofertave Na KVO shoqëria jonë e cila ka paraqitur ofertën më të ulët është skualifikuar nga kjo procedurë prokurimi me arsyetimin që nuk kemi paraqitur Licencë QKL dhe/ose QKR për import-eksport, tregti të materialeve për përdorim mjekësor e cila është kërkuar në pikën 2.1 të kapacitetit ligjor i operatorëve ekonomikë.

Arsyeja e skualifikimit të shoqërisë sonë nga kjo procedurë prokurimi na duket e padrejtë pasi bazuar në VKM-në nr. 538 datë 26.05.2009 për “Licencat lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të Licencimit (QKL)dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”

Aktiviteti: “Import-Eksport tregti të materialeve me përdorim mjekësor”, nuk është një aktivitet i cili licencohet nga QKL apo Ministria e Shëndetësisë. Ne kemi përshkruar këtë object aktiviteti në ekstraktin e QKR-së të cilin po e paraqesim bashkëlidhur kësaj ankese.

Ankesën tonë e kemi paraqitur fillimisht Brenda afateve ligjore pranë AK-së protokolluar me nr. 862prot datë 29.06.2017, i cili pas shqyrtimit të ankesës me shkresën nr. 862/2prot datë 30.06.2017 pranon që pretendimi i shoqërisë sonë qëndron, por KVO ka qënë e detyruar të zbatoj kriteret e vendosura nga njësia prokuruese.

Ju bëjmë me dije se i njëjti kriter është venosur në të njëjtën procedurë prokurimi në vitin 2016 nga po i njëjti autoritet kontraktor, dhe pas ankimit tonë në KPP, AK-ja n aka kërkuar të tërhiqemi nga ankimi që kishim bërë pasi kishin urgjencë për materialet e prokuruarra dhe mungesa e këtij dokumenti do të konsiderohej devijim i vogël nga kërkesat e tenderit dhe shoqëria jonë është shpallur fituese e kësaj procedure prokurimi. Gjithashtu kemi nënshkruar dhe realizuar me sukses kontratën të cilën po e bashkëngjisim. Bashkëlidhur po ju dërgojmë edhe ankesën tonë bërë në vitin 2016 pranë KPP-së dhe vendimin e KPP-së nr. 197/2016. Duke besuar se ankesa jonë është e drejtë dhe e bazuar në ligj, mbetemi në pritje të një vendimi nga ana juaj.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.993/1 prot., datë 02.08.2017 protokolluar me tonën me nr.1224/3 datë 03.08.2017 me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Saer Medical” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “.Nuk ka paraqitur *Licensë QKL ose QKR për import-eksport tregëti të materialeve për përdorim mjekësor* ”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në Shtojcën 7 “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*” pika 2.1 “*Kapaciteti ligjor*” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteret si më poshtë:
Licensë QKL dhe /ose QKR për import – export, tregëti të materialeve për përdorim mjekësor.

III.1.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Saer Medical” shpk ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

Ekstrakt Historik i Regjistrit; Emri i Subjektit: “Saer Medical” shpk në pikën 9 objekti i aktivitetit: “Import –Eksport i të gjitha mallrave industrial, ushqimore, blektorale, buqësore, materialeve të ndërtimit, lëndë të para për industrinë dhe sektorë të tjerë. Instalim servis, asistencë teknike për aparaturat elektromjekësore dhe materialet me përdorim mjekësore, tregëtimi i tyre me shumicë dhe pakicë, import eksport, import eksport, import tregëtim me shumicë e pakicëtë barnave”

III.1.3. Në nenin. 46 pika 1 gërma “a”, të Ligjit Nr.9643 dt.20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, i cili parashikon se: “[...] *kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregëtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata; [...]*”.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...*”

III.1.4. Në ligjin Nr.10 081, datë 23.2.2009 “*Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë*” shtojca bashkëlidhur ligjit [...] *Fusha II Pika 6 Licencë Shërbime mjekësore parësore, spitalore ose të stomatologjisë*

Pika 7 Licencë Prodhimi dhe /ose tregëtimi i barnave për njerëz ose kafshë

Pika 8 Licencë Shërbime të tjera shëndetësore dhe/ose higjeno-sanitare[...]

III.1.5. Në Vendimin Nr. 538, datë 26.5.2009, “*Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta*”,

(Ndryshuar me VKM nr. 385, datë 19.5.2010, nr. 436, datë 16.6.2011, nr. 956, datë 9.5.2012, nr. 421, datë 15.5.2013, nr. 26, datë 20.01.2016)

[...]Veprimtaria e shërbimeve mjekësore parësore spitalore ose të stomatologjisë është kategoria II.6. të shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”

Kategoria e kësaj veprimtarie ndahet në dy nënkategori si vijon:

a) “*Shërbime mjekësore parësore dhe/ose stomatologjike*” me kodin II.6.A;

b) "Shërbime spitalore" me kodin II.6.B.

3. Licencat e nënkategorive të kategorisë A dhe B, janë pa afat.

II. LICENCIMI I VEPRIMTARIVE TË NËNKATEGORISË II.6.A

4. Veprimtaritë e nënkategorisë II.6.A specifikohen në:

a) "Shërbime laboratorike": mikrobiologjik, klinik biokimik, imunologjik gjenetik anatomo-patologjik, citologjik, stomatologjik, optik dhe specialitete të tjera me kodin A.1;

b) "Kabinete mjekësore": vetëm me një specialitet mjekësor të tilla si kabinete imazherie, kabinet optik me opticien, kabinet i diagnozës endoskopike dhe specialitete të tjera, me kodin A2;

c) "Shërbime stomatologjike": klinika dhe/ose kabinet stomatologjik, me kodin A.3;

d) "Qendër mjekësore": me disa specialitete mjekësore për vizita dhe konsulta mjekësore, diagnostifikim, trajtime ambulatorë, trajtime mikrokirurgjikale, me kodin A4;

e) "Shërbime të tjera shëndetësore e kurative": fizioterapi, qendra estetike ku afrohet shërbim mjekësor, qendra të trajtimit të vartësisë nga droga, qendra balneare, të kujdesit paliativ dhe të tjera, me kodin A.5.

[...]

Veprimtaria e "Prodhimit dhe/ose tregtimit të barnave (për njerëz ose kafshë)" është kategoria II.7 e shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë"

2. Kategoria e kësaj veprimtarie ndahet në tre nënkategori si vijon:

a) "Farmacitë ose agjencitë farmaceutike" me kodin II.7.A;

b) "Tregtimi me shumicë i barnave", me kodin II.7.B;

c) "Prodhimi i barnave", me kodin II.7.C.

3. Licencat e nënkategorive të kategorisë A, B dhe C, janë pa afat

4. Veprimtaritë e nënkategorive A, B, C specifikohen në:

a) Barna për njerëz. Kodit përkatës i shtohet në fund numri 1;

b) Barna për kafshë. Kodit përkatës i shtohet në fund numri 2.

II. BARNAT PËR NJERËZ II.1 Licencimi i veprimtarive të nënkategorisë II.7.A.1 5. Kjo veprimtari dallohen në farmaci dhe agjenci farmaceutike. Kodit përkatës i shtohen respektivisht gerrat F dhe Af.[..]

[...] Veprimtaritë që kryejnë "shërbime të tjera shëndetësore ose higjiëno-sanitare" janë ato të përcaktuara në kategorinë II.8 të shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" 10

2. Veprimtaritë e kësaj kategorie ndahen në dy nënkategori si vijon:

a) "shërbime ekspertize higjiëno-shëndetësore" me kodin II.8.A;

b) "shërbime ndërhyrëse higjiëno-shëndetësore" të tilla dezinfektimi, deratizimi, dizensektimi dhe të tjera të këtij lloji me kodin II.8.B.

c) veprimtari në fushën e shëndetit publik që nuk licencohen sipas një kategorie tjetër me kodin II.8.C.

[...]

III.1.6. Autoriteti Kontraktor me shkresën nr. 862/2prot prot datë 30.06.2017 me objekt "Kthim përgjigje" citon se: [...]

Në pikën 2.1 Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë kërkohet: Licencë QKL dhe/ose QKR për import-eksport, tregti të materialeve për përdorim mjekësor.

Komisioni i vlerësimit të ofertave ka qënë i detyruar të zbatoi kriteret e vendosura nga njësia prokuruese në DST dhe për skualifikimin tuaj.

Pra pretendimi juaj qëndron por këtë ankesë duhej ta kishit paraqitur Brenda afatit ligjor, përpara se të hapej vlerësimi i ofertave në mënyrë që të bëhej modifikimi i DST-ve[...]

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga sa më lart, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton dhe kërkesat e veçanta për kualifikim, duke mbajtur në konsideratë kufijtë maksimal të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik. Në këtë kuptim, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetin ligjor lidhur me objektin e aktivitetit të duhur, vërtetuar kjo edhe nëpërmjet dokumentave të tilla si Ekstrakt Historik.

III.1.8. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, K.P.P. sqaron se aktiviteti i tregtimit të materialeve mjekësore nuk është aktivitet i cili licencohet duke u bazuar në legjislacionin e sipërcituar konkretisht në Vendimin Nr. 538, datë 26.5.2009, *“Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”*, [...], por objekti i aktivitetit të tregtimit të materialeve mjekësore përshkruhet në objektin e aktivitetit të Ekstraktit Historik të lëshuar nga QKB-ja. Sa më sipër nëse Autoriteti Kontraktor do të kishte dyshime të arsyeshme mbi *“Licensë QKL dhe /ose QKR për import – export, tregti të materialeve për përdorim mjekësor”* të mund ti drejtohej vet organit që i lëshon për konfirmimin e tyre. Akoma më tej referuar kthim përgjigjes nr. 862/2 prot., datë 30.06.2017 të autoritetit kontraktor drejtuar ankimuesit pranohen pretendimet e tij si të drejta, por autoriteti kontraktor argumenton që ky kriter tashmë është vendosur dhe duhet të plotësohet. Sqarojmë autoritetin kontraktor se përcaktimi i kritereve për kualifikim duhet të burojnë së pari nga ligji dhe së dyti të jenë në përputhje me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit, të argumentuara dhe justifikuar sipas objektit përkatës. Sa më sipër rezulton se operatori ekonomik ankimues ka paraqitur Ekstraktin Historik, në të cilin përshkruhet objekti i aktivitetit. Për këtë arsye, Komisioni e konsideron të përmbushur kërkesën e sipërcituar të autoritetit kontraktor.

Pra sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 *“Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Saer Medical” sh.p.k., për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me objekt “Blerje filma skaneri, grafie dhe solucione”, me fond limit 1.000.000 lekë pa tvsh i ndarë në lote:
 - Loti 1 “Filma rontgeni dhe solucione”, me Nr.REF-16333-06-05-2017, me vlere 924 402 leke pa tvsh, e zhvilluar në datën 19.06.2017, nga autoriteti kontraktor, Spitali “Ihsan Cabej” Lushnjë.
 - Loti 2 “Filma skaneri”, me vlere 75 598 leke pa tvsh, me Nr.REF-16335-06-05-2017,e zhvilluar në datën 19.06.2017, nga autoriteti kontraktor, Spitali “Ihsan Cabej” Lushnjë.
2. Autoriteti kontraktor të anulohet vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Saer Medical” sh.p.k dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor të njoftojë Komisionin e Prokurimit Publik mbi zbatimin e këtij vendimi brenda 10 ditëve, në përputhje me parashikimet e Vendimit nr. 482 datë 05.07.2017 të Këshillit të Ministrave “Për Pezullimin e Përkohshëm të Procedurave të Prokurimit, për Vitin 2017”.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Saer Medical” sh.p.k.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. **Public Health Sector**

Nr.1224Protokolli; Datë 05.07.2014

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Leonard Gremshi	Hektor Balluku	Kleves Janku	Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha